




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

KORAB R. SEJDIU
Deputet
Poslanik – Representative

REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA E KOSOVES / SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA / ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO	
Propozime dhe Propozime-Aspiracione za Fredlogje i Prodëstevka-Table Office	
Nr. Prot. / Prot. No. / No. Prot.	06/578/10-355
Nr. Fqesave / Broj. Pristaca / No. Pristaca	
Data / Datum / Date	19.01.2018
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA	

Për / Za / For:	Z. Bedri Hamza, Ministër Ministria e Financave
Nga / Od / From:	Korab R. Sejdiu, Deputet 
Data / Datum / Date:	19 janar 2018
Referenca / Referenca / Reference:	
Lënda / Predment / Subject:	Pyetje parlamentare për përgjigje me shkrim

Në bazë të Nenit 46 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, shtroj pyetje parlamentare për përgjigje me shkrim.

Çështja: Kohëve të fundit, jemi dëshmitarë të paraqitjes së kriptovalutave në tregjet financiare ndërkombëtare, me që rast, ka një përqëndrim të madh të investitorëve në këto produkte financiare. Njëkohësisht, jemi dëshmitarë të një trendi të pjesëmarrjes masive të qytetarëve të Republikës së Kosovës në këto investime të dyshimta, përfshirë edhe shumë të cilët po shesin edhe asetet më elementare personale për të investuar në kriptovaluta.

PYETJA: Z. Ministër, pasur parasyshë se disa analistë me renome ndërkombëtare kanë paralajmëruar lidhur me rrezikun e investimit në kriptovaluta dhe kanë vlerësuar kriptovalutat si fluska apo skema piramidale që do të përfundojnë me debakël për investitorët, si dhe pasur parasyshë pjesëmarrjen e madhe të qytetarëve tanë në këto investime, a ka Ministria e Financave ndonjë plan konkret për të adresuar kriptovalutat dhe për të parandaluar pasojat potencialisht shkatërruese për ekonominë tonë delikate. Dhe nëse po, atëherë, cilat janë ato veprime që Ministria e Financave planifikon të ndermerr, veçanërisht duke pasë parasyshë urgjencën e trajtimit të kësaj çështjeje.

Email: Korab.Sejdiu@assembly-kosova.org
Tel: +377 (0)44 470 045
Skype: korab.r.sejdiu

Ndërtesa e Kuvendit
Sheshi Nëna Tereze
Kutia/Box 70
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI / REPUBLIKËS SË KOSOVËS
SKUPSTINA REPUBLIKE KOSOVA
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Kancelaria e Propozimeve dhe Propozimeve Konceptuale / Konceptori i Propozimeve / Predstavnik-Table Office

No. Prop. / Br. Prop. / Prop. No. **06/381/10-266**

Data / Datum / Date **11.12.2017**

PRISTINE - PRISTINA - PRISTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

PËR / ZA / TO	Kryeministrin e Republikës së Kosovës z. Ramush Haradinaj	DATE DATU M	11.12.2017
		DATE Reference	
SEPAR KON	Avdullah Hoti - Deputet i Grupit Parlamentar të LDK-së		
SUBJE KI PRED MET SUBJE CT	Pyetje parlamentare për përgjigje me gojë		

Në bazë të Nenit 45 pika (2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, shtroj pyetje parlamentare për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja: Sipas deklarimeve të zyrtarëve të Qeverisë, situata e furnizimit me energji elektrike mund të përkeqësohet së shpejti. KEK-u mund të ketë mungesë të thëngjillit për shkak të pamundësisë në qasje në lokacione ku nxirret thëngjilli si rezultat i vonesave në zhvendosjen e banorëve të fshatrave Hade dhe Shipitullë. Kryeministri Haradinaj ka takuar disa herë banorët e këtyre fshatrave. Në takim të tij në fillim të mandatit, u deklaruar në medie se është arritur marrëveshje. Ndërkaq, në takim në javën që shkoi, Kryeministri publikisht deklaroi se ky proces po mbahet peng nga disa matrapazë (siç i quajti ai) dhe se do të nisë bagerat nëse ata nuk nënshkruajnë kontratat e ofruara. Po sipas Kryeministrit, çmimi që ju është ofruar banorëve për tu zhvendosur është shumë më i lartë se vlerësimi i pronës së tyre në rast se shkohet me ligjin e shpronësimeve.

PYETJA: Çfarë po ndodh me këtë proces? Kur pritet të zhvendosen banorët e këtyre fshatrave? Kush janë matrapazët sipas Kryeministrit? A mendoni se me këtë involvim Kryeministrit po ndikon në proces në kundërshtim me ligjin?



KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS
SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVO
ASSEMBLY OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

06/589/10-366

22.01.2018

PRISHTINE

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

	z. Ramush Haradinaj Kryeministër i Kosovës		22.01.2018
		Reference	
	Arbër Rexhaj Deputet i GP Lëvizja VETËVENDOSJE!		
	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Pyetja Parlamentare:

Kryeministër pyetja ime ka të bëjë me 93 ish – punëtorët e KEDS-it, të cilët kanë pasur kontrata të përhershme, dhe atyre iu është ndërprerë kontrata e punës pa asnjë shpjegim në vitin 2016. Punëtorët e larguar të KEDS-it e kanë ngritur rastin në gjykatë, inspektorati i punës me vendim egzekutiv ka dhënë vendim për kthimin e tyre në punë. Cka do të bëhet me fatin e këtyre punëtorëve, pot ë drejtohem ty kryeministër që të interferoh për të sjellur së paku drejtësi morale, sepse e drejta është në anën e atyre punëtorëve.